



AMBIENTI
KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 1490
DATA 30.06.26

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, dhe rregulloren e brendshëm për rregullimin e procedurave te konkursit nr 3090 e datës 21.11.2025 Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 01.07.2026, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Sigurim i Objektiv (Roje) - 1 pozitë

Vendi punës : Sferkë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koeficienti i pagës : 2.2

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Përcjellë hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve.
2. Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të veçantë.
3. Palëve u jep fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara.
4. Është i obliguar për sjellje korrekte me palët dhe për qëndrim në vendin e tij të punës.
5. Bënë sigurimin e objektivit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor.
6. Bënë shiqimin e gjendjes së objektivit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullësis së tyre.
7. Kontrollon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektivit.
8. Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektivit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara.
9. Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektivit e informon punëtorin e sigurimit të radhës.
10. Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën.
11. Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të pautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes.
12. Është përgjegjës i përgjithshëm i materialit dhe automjeteve, gjatë kohës së orarit të punës, me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës.
13. Ndalon personat dhe automjetet e pa autorizuar dhe ndalon hudhjen e mbeturinave nga ana e popullatës lokale.
14. Të kryej punë të cilat i besohen mbrenda ditës, të ketë kujdesë në punë në mënyrë që mos të vjen gjerë te ndezja e mbeturinave.
15. Në rast të ndonjë avarie, ta evitojë atë dhe të lajmëroj shefin e sigurimit dhe organet Kompetente;
 - Ndhma e shpejtë – 194,
 - Emergjencia Civile – 112,
 - Zjarrëfikësit – 193,
 - Policia – 119.
16. Të punojë të shtunave dhe të dielave.
17. Kryen pune bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të shefit të sigurimit.
18. Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.



AMBIENTI
KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkollimin fillor përparësi shkollimi i mesëm;
- Përparësi janë certifikimet në siguri
- Aftësi shumë të mira organizative
- Njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen në e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 01.07.2026 deri me 16.07.2026 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.